



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 262, datë 13.11.2019

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES PËR EMËRIM NË GJYKATËN E LARTË TË KANDIDATËVE, NGA RADHËT E JURISTËVE TË SPIKATUR, PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.172, DATË 11.09.2019, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 136, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 49, pikat 6, 7 dhe 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në Kreun V, Seksioni A, pikat 1 dhe 3, të Vendimit nr.102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, mbas realizimit të shortit për zgjedhjen e relatorit,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e z. Dritan Hallunaj si relator për procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Vendimi i vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit z.Ervin Pupe i marrë në kuadër të procedurës së përzgjedhjes për emërim për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor është i vlefshëm edhe për procedurën e përzgjedhjes për emërim për pozicionin e lire të shpallur me Vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR